



A.nr.182/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, dhe Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.182/2026, të datës 19.02.2026, të parashtruar nga ankuesja F.H, të cilën me autorizim e përfaqëson Fitim Gashi avokat nga Prishtina, kundër Vendimit Nr.112/2026 të datës 20.01.2026 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedura administrative e iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.182/2026, të datës 19.02.2026, të parashtruar nga ankuesja F.H.

A r s y e t i m

Ankuesja, F.H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), përmes përfaqësuesit të saj më autorizim, më datë 19.02.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.112/2026, të datës 20.01.2026, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjell përgjigje në pretendimet ankimore të ankueses.

Kolegji i Këshillit pas analizimit të provave të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ lidhur me ankesën e ankueses, **sepse:**

I. Vlerësimi i gjendjes së çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Ankuesja sipas Akt Emërimit AE.Nr. 1243/2021, të datës 16.11.2021, ka ushtruar pozitën Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim me Organizata Vendore e Ndërkombëtare në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

- Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, më Vendimin Nr. 112/2026, të datës 20.01.2026, ka transferuar përkohësisht ankuesen nga pozita Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim me Organizata Vendore e Ndërkombëtare në pozitën Zyrtare për të Huaj, për një periudhë prej një (1) viti.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit Nr. 112/2026 të datës 20.01.2026 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më pretendimin se nuk është transferuar në të njëjtën kategori pasi që ka qenë me koeficient të pagës tetë (8) dhe krejt ky transferim është degradim. Kërkon që KPMSHCK-ja të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloi vendimin e kontestuar si të paligjshëm.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në provat materiale të dorëzuara nga MPB-ja përmes përgjigjes në ankesë ka konstatuar se ankuesja më datë 04.02.2026, ka parashtruar kërkesë pranë Njesisë së Personelit të MPB-për dorëheqje nga pozita e punës në MPB dhe atë me efekt prej datës 05.02.2026, ndërsa, Njësia e Personelit të MPB-së, më Vendimin Nr.260/2026, të datës 04.02.2026, ka liruar nga shërbimi civil ankuesen mbi bazën e dorëheqjes me efekt nga data 05.02.2026. Andaj, mbi këtë rrethanë, objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ sipas ankesës është bërë i kotë, sepse, shqyrtimi i ligjshmërisë së aktit të kontestuar nuk mund të prodhoj pasoja juridike në raport me palën ankuese, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*”, Kolegji vendosi në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.182/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuses Gashi & Partners Law Firm me Avokat Fitim Gashi;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;